VENDIM
Nr.660, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS LIBONIK TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Libonik të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 642 (gjashtëqind e dyzet e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Libonik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Libonik — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
20-26 (vetëm objekti)	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
13-19	Prona që përdoren në fushën social kulturore sportive.	Në pronësi
27-40	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
41-57	Shërbim funeral	Në pronësi
259-418 (vetëm troje)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndëmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji.	Në përdorim
73-255,259-418 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë, sheshe, rrugë vendore, lulishte, dhe shërbime publike.	Në pronësi
467,468,471-474,476-479,481, 482,485,487,488,491,492	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
469,470,475,480,483,484, 486,489,490,493,494,527, 537,553,560,571,573	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
58-72	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi